



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr.02/ 410

Datë: 03.11.2020

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika c, nenit 17 shkronja i, nenit 40 paragrafi 2 pika a, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 13 paragrafi 1, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për Transparencë në Komuna, nenit 7 paragrafi 1, pika 1.2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/20018, për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, në bazë të nenit 10 paragrafi 1 shkronja r, nenit 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2, nenit 19 paragrafi 7 pika e, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në vazhdimin e mbledhjes se -VII- (shtatë) të mbajtur me datë: 30.10.2020 miraton këtë:

V E N D I M

PËR PARAQITJEN NË DISKUTIM PUBLIK TË DRAFT-RREGULLORËS PËR
PËRKUJDESJEN DHE MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

1. Miratohet vendimi për paraqitjen në debat-konsultim publik të Draft-Rregullore për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Komunën e Malishevës.
2. Diskutimi publik paraqitet në afat prej 14 (katërmëdhjetë) ditëve, nga dita e shpalljes-paraqitjes së ftesës në tabelën e shpalljeve publike të Komunës së Malishevës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim dhe Edukim përmes Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe koordinatores për të drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullore (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet
Arkivit të Komunës
MAPL-së
Drejtorive të KK-së.

